



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 437/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.07.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-21418-05-10-2019, me objekt “*Furnizimin me materiale mjekësore (proteza) për shërbimin e ortopedisë*” - *Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar*”, me fond limit 13.891.734 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Lezhë.

Ankimues: “Labopharma” sh.p.k.
Rruga “Siri Kodra”, tek ish frigoriferi, nr 149, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Lezhë
Lagja “Varosh”, Lezhë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-21418-05-10-2019, me objekt “*Furnizimin me materiale mjekësore (proteza) për shërbimin e ortopedisë*” - Marrëveshje Kuadër me nje operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar”, me fond limit 13.891.734 lekë (pa TVSH).

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, në datën 20.05.2019, operatori ekonomik ankimues “Labopharma” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kriterëve të kualifikimit.

Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...] Në shtojcën 10 “*Specifikimet teknike*” për artikullin “*koka femorale*”, kërkohet që: *Seria e kokave duhet të ketë 5 përmasa dhe dimensionet të variojnë nga -3.5mm deri në +10.5mm me një devijacion maksimal +/-10%.*

Duke u përcaktuar nga ana juaj diapazoni milimetrik ku duhet të gjenden 5 përmasat, kufizohet konkurenca dhe orientohet gara drejt një prodhuesi të vetëm, pasi prodhues të ndryshëm aplikojnë si element të dizajnit intervale të ndryshme nga përmasa në përmasë. Intervale të ndryshme të aplikuar nga prodhues të ndryshëm janë të nivelit milimetrik, madje me presje dhjetore por nga pikëpamja funksionale janë gjithsesi brenda parametrave anatomikë dhe etë miratuara sipas standarteve FDA dhe CE.

Në praktikën ortopedike botërore por edhe në praktikën e kërkesave të përdorura nga Spitalet Rajonale në Shqipëri sistemi universal dhe i gjithëpranuar i përmasave për këtë artikull jepet nëpërmjet dimensioneve “small, medium, large, extralarge, extraextralarge”. Këtë sistem përmasash kanë kërkuar edhe spitale të tjerë në Shqipëri si psh Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës në procedurën me nr. Ref-17929-04-12-2019 madje edhe Spitali Universitar i Traumës që është mjaft i specializuar në këtë drejtim në procedurën me nr, Ref. -05026-01-24-2019.

Për arsyet e mësipërme me qëllim saktësimin e terminologjisë së përmasave dhe zgjerimin e konkurrencës kërkojmë që ky specifikim të modifikohet dhe të bëhet “Seria e kokave duhet të ketë të paktën 5 përmasa: small, medium, large, extralarge, extraextralarge”.

2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” në specifikimet e artikullit “Koka bipolare” kërkohet që: të ketë të integruar një fill metalik me dy dalje në sipërfaqe metalike me unazë fill bllokuese metalike ose plastike”.

Ky specifikim në vetvete duket se ka të bëjë me nevojën që koka bipolare të jetë e pajisur me një mekanizëm bllokues. Nga ana tjetër konstatojmë se pjesa e parë e fjalisë që thotë: “Të ketë të integruar një fill metalik me dy dalje në sipërfaqe metalike” nuk ka kuptim për sa kohë kërkesën e mekanizmit bllokues e përshkruan qartësisht pjesa e dytë e fjalisë që thotë: “me unazë fill bllokuese metalike ose plastike”. Pra pjesa e parë e fjalisë jo vetëm krijon konfuzion dhe është kontradiktore me pjesën e dytë, por edhe është një përshkrim i dizajnit dhe jo i funksionit, dizajn që orienton tek një markë e vetme, pasi funksioni është bllokimi dhe ky funksion realizohet me fill ose me unazë bllokimi metalike ose plastike. Çdo përshkrim tjetër si “dy dalje në sipërfaqen metalike” thjesht orienton drejt dizajnit duke kufizuar konkurrencën.

Për arsyet e mësipërme në zbatim edhe të nenit 42 të LPP, kërkojmë të saktësohet /modifikohet specifikimi si vijon: “Të ketë unazë/fill bllokues, që të jetë metalike ose plastike”.

II.3. Operatori ekonomik ankimues sqaron se në datën 23.04.2019 ka marrë në dorëzim shkresën nr. 497/1 prot., datë 20.04.2019 të autoritetit kontraktor ku ankesa nuk pranohet.

II.4. Në datën 28.05.2019 operatori ekonomik “Labopharma” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 10.06.2019, nëpërmjet shkresës nr. 479/3 Prot., datë 06.06.2019, me objekt “Kthim përgjigje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Labopharma” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Labopharma” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, me pretendimin se: [...] Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” për artikullin “koka femorale”, kërkohet që: *Seria e kokave duhet të ketë 5 përmasa dhe dimensionet të variojnë nga -3.5mm deri në +10.5mm me një devijacion maksimal +/-10%.*

Duke u përcaktuar nga ana juaj diapazoni milimetrik ku duhet të gjenden 5 përmasat, kufizohet konkurrenca dhe orientohet gara drejt një prodhuesi të vetëm, pasi prodhues të ndryshëm aplikojnë si element të dizajnit intervale të ndryshme nga përmasa në përmasë. Intervalet e ndryshme të aplikuar nga prodhues të ndryshëm janë të nivelit milimetrik, madje me presje dhjetore por nga pikëpamja funksionale janë gjithsesi brenda parametrave anatomikë dh etë miratuara sipas standarteve FDA dhe CE.

Në praktikën ortopedike botërore por edhe në praktikën e kërkesave të përdorura nga Spitalet Rajonale në Shqipëri sistemi universal dhe i gjithëpranuar i përmasave për këtë artikull jepet nëpërmjet dimensioneve “small, medium, large, extralarge, extraextralarge”. Këtë sistem përmasash kanë kërkuar edhe spitale të tjerë në Shqipëri si psh Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës në procedurën me nr. Ref-17929-04-12-2019 madje edhe Spitali Universitar i Traumës që është mjaft i specializuar në këtë drejtim në procedurën me nr, Ref. -05026-01-24-2019.

Për arsyet e mësipërme me qëllim saktësimin e terminologjisë së përmasave dhe zgjerimin e konkurrencës kërkohet që ky specifikim të modifikohet dhe të bëhet “Seria e kokave duhet të ketë të paktën 5 përmasa: small, medium, large, extralarge, extraextralarge”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 10 Specifikimet teknike, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: *Kokat femorale: Seria e kokave duhet te ketë 5 përmasa dhe dimensionet te variojnë nga -3.5mm deri në +10.5mm me një devijacion maksimal +/-10%[...]”.*

III.1.2. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit.

Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

III.1.3. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet se "*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*".

III.1.4. Në nenin 30 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: "[...] *Procedura e hapur është procedura e preferuar në prokurimet.*"

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma "b" dhe "c" e LPP-së), janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu, edhe metoda e tretë, e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.1.6. Sa më sipër, KPP gjykon se, për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurrentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët.

Sqarojmë se, autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknikë kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, referuar hulumtimeve të prodhuesve më të njohur në treg për këtë produkt, standarteve ndërkombëtare, konstatojmë se kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit është kufizuese dhe diskriminuese.

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar edhe pretendimeve të ankimesit, referuar hulumtimeve të prodhuesve më të njohur në treg për këtë produkt, standarteve ndërkombëtare, referuar edhe praktikave të procedurave të prokurimit të kryera nga drejtoritë e ndryshme spitalore në territorin e Shqipërisë, nisur kjo nga nevojat përkatëse, për të cilat ka pasur edhe ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim unifikimin e këtyre specifikimeve, konstatojmë se, autoriteti

kontraktor duhet të bëjë modifikimin e këtij kriteri duke përcaktuar dimensionet në ndarjet e përmasave S, M, L, XL, XXL, duke u përshtatur kështu me standartet ndërkombëtare, si edhe praktikatat e tjera në vend.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës, duke përcaktuar ndarjet e përmasave si më sipër cituar, me qëllim hapjen e konkurrencës dhe lejitimin e një numri sa më të madh të operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me këtë parametër qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “2. Në shtojcën 10 “*Specifikimet teknike*” në specifikimet e artikullit “*Koka bipolare*” kërkohet që: të ketë të integruar një fill metalik me dy dalje në sipërfaqe metalike me unazë fill bllokuese metalike ose plastike”.

Ky specifikim në vetvete duket se ka të bëjë me nevojën që koka bipolare të jetë e pajisur me një mekanizëm bllokues. Nga ana tjetër konstatojmë se pjesa e parë e fjalisë që thotë: “Të ketë të integruar një fill metalik me dy dalje në sipërfaqe metalike” nuk ka kuptim për sa kohë kërkesën e mekanizmit bllokues e përshkruan qartësisht pjesa e dytë e fjalisë që thotë: “me unazë fill bllokuese metalike ose plastike”. Pra pjesa e parë e fjalisë jo vetëm krijon konfuzion dhe është kontradiktore me pjesën e dytë, por edhe është një përshkrim i dizajnit dhe jo i funksionit, dizajn që orienton tek një markë e vetme, pasi funksioni është bllokimi dhe ky funksion realizohet me fill ose me unazë bllokimi metalike ose plastike. Çdo përshkrim tjetër si “dy dalje në sipërfaqen metalike” thjesht orienton drejt dizajnit duke kufizuar konkurrencën.

Për arsyet e mësipërme në zbatim edhe të nenit 42 të LPP, kërkojmë të saktësohet /modifikohet specifikimi si vijon: “Të ketë unazë/fill bllokues, që të jetë metalike ose plastike”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10 Specifikimet teknike, për produktin “Koka Bipolare”, nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar specifikimet teknike: “[...]Te ketë të integruar një fill metalik me dy dalje në sipërfaqe metalike me unazë fill bllokuese metalike ose plastike. [...]”.

III.2.2. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

b) *kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

c) *të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

III.2.3. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikohet se “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPPdhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*”.

III.2.4. Sa më sipër, KPP gjykon se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët. Sqarojmë se autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë specifikime teknike kufizuese e përjashtuese, por duhet të përcaktojë specifikime të tilla me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

III.2.5. Sa më sipër, KPP gjykon se, për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët.

Sqarojmë se, autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk duhet të përcaktojë parametra teknikë kufizues e përjashtues, por duhet të përcaktojë parametra minimalë me qëllim pjesëmarrjen e një numri sa më të lartë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, referuar hulumtimeve të prodhuesve më të njohur në treg për këtë produkt, standarteve ndërkombëtare, konstatojmë se kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit është kufizuese dhe diskriminuese e për më tepër shkakon konfuzion dhe dublike.

Hartimi i këtij kriteri në thelb ka të bëjë me funksionin e kokës bipolare dhe me faktin që koka bipolare të ketë një mekanizëm bllokues.

Përcaktimi që ka “të ketë të integruar një fill metalik me dy dalje në sipërfaqe metalike” është kontradiktor dhe shkakton paqartësi me përcaktimin (fjalinë në vijim të kriterit) “me unazë fill bllokuese metalike ose plastike” si tek operatorët ekonomikë gjatë hartimit dhe përgatitjes së ofertave ashtu edhe tek autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave.

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar edhe pretendimeve të ankimuesit, referuar hulumtimeve të prodhuesve më të njohur në treg për këtë produkt, standarteve ndërkombëtare, konstatojmë se, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e këtij kriteri, duke përcaktuar dhe saktësuar këtë kriter duke hequr përcaktimet e panevojshme dhe kontradiktore që shkaktojnë konfuzion.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.

Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës, me qëllim hapjen e konkurrencës dhe lejimin e një numri sa më të madh të operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me këtë parametër qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Labopharma” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-21418-05-10-2019, me objekt “*Furnizimin me materiale mjekësore (proteza) për shërbimin e ortopedisë*” - Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar”, me fond limit 13.891.734 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Lezhë.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Labopharma” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 950 Protokolli

Datë 28.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha